



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e KD-së
Dr. Albana Rexha

Nr. Prot. 2112 Dt. 11.09.2026

Duke u mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenet 18 dhe 24 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe duke pasur parasysh ndryshimin e rrethanave që kanë justifikuar caktimin e ushtruesit të detyrës, Këshilli Drejtues i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 10.09.2026, mori:

VENDIM


- I. Shfuqizohet Vendimi i Këshillit Drejtues të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, me nr.prot.783 i datës 07.04.2026, me të cilin z. Shkumbin Imeri, i ishte vazhduar periudha si ushtrues detyre i sekretarit të përgjithshëm të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, për periudhën kohore deri në 6 (gjashtë) muaj.
- II. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, z. Shkumbin Imeri lirohet nga ushtrimi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi më datën 16.09.2026.

Arsyetim

Vendimi i datës 07.04.2026 ishte miratuar për shkak të mungesës së përkohshme të sekretarit të përgjithshëm, z. Avdyl Beqiri, i cili ishte në pezullim vullnetar (pushim pa pagesë) të marrëdhënies së punës. Meqenëse rrethanat për të cilat ishte caktuar dhe vazhduar ushtruesi i detyrës kanë ndryshuar, për shkak të njoftimit për kthim të sekretarit të përgjithshëm në vendin e punës, ekziston baza ligjore dhe faktike për shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur. Këshilli Drejtues, në ushtrim të kompetencave të tij statutore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Këshillit Drejtues të UIBM;
3. Menaxhmentit të UIBM;
4. Të përmendurit;
5. Zyrës së personelit;
6. Zyrës për Buxhet dhe Financa;
7. Zyrës për Informim me Publikun;



Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://ëëë.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1